



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
SHËRBIMI I PROVËS  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

**R A P O R T**  
**PËR PERIUDHËN 1 JANAR - 28 SHKURT 2011**

## **I nderuar Zoti Ministër,**

Mbështetur në nenin 9, gërma gj), të VKM nr. 302, datë 25.03.2009 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative", po Ju paraqesim raportin e veprimtarisë së Shërbimit të Provës për periudhën 1 Janar - 28 Shkurt 2011.

### **I. Statistika**

Për periudhën 1 Janar - 28 Shkurt 2011, volumi i punës së kryer nga Shërbimi i Provës ka qenë i madh, duke marrë parasysh faktin që megjithë hapjen e 4 Zyrave të reja Vendore, numri i specialistëve të Zyrave Vendore të Shërbimit të Provës është i njëjti, ndërsa numri i të dënuarve me dënime alternative që këta specialistë mbikëqyrin, si dhe kërkesat nga gjykatat dhe prokuroritë për raporte vlerësimi janë në rritje të vazhdueshme. Disa nga statistikat dhe paraqitjet që pasqyrojnë punën që ka kryer e po kryen institucioni do të jepen me anë të të dhënave si më poshtë:

Për periudhën 01 Qershor 2009 - 28 Shkurt 2010, statistikat rezultojnë si më poshtë:

#### *1. Numri total i të dënuarve me dënime alternative të dhëna nga gjykatat.*

**Numri total i të dënuarve** me dënime alternative që janë mbikëqyrur nga Shërbimi i Provës në të gjithë vendin, për periudhën **01.06.2009 - 28.02.2011**, është **2870** të dënuar.

Nga 01.06.2009 deri më datë 28.02.2011, kanë përfunduar periudhën e provës nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës **292** të dënuar, pra ka përfunduar me sukses procesi i mbikëqyrjes për ta.

Kështu numri total i të dënuarve që ndodhen aktualisht nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës (duke zbritur numrin e atyre që kanë përfunduar dënimin alternativ) është **2578 të dënuar**.

I ndarë sipas Zyrave Vendore (duke llogaritur dhe të dënuarit që kanë përfunduar dënimin alternativ):

- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Tiranë mbikëqyrin në komunitet nga Shërbimi i Provës **1069** të dënuar me dënime alternative.

- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Durrës mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **239** të dënuar me dënime alternative.
  - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Fier mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **410** të dënuar me dënime alternative.
  - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Shkodër mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **371** të dënuar me dënime alternative.
  - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Lezhë mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **149** të dënuar me dënime alternative.
  - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Elbasan mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **133** të dënuar me dënime alternative.
  - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Korçë mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **150** të dënuar me dënime alternative.
  - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Gjirokastrë mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **57** të dënuar me dënime alternative.
2. *Numri mesatar i të dënuarve me dënime alternative që mbikëqyren nga një punonjës i Shërbimit të Provës në nivel vendi dhe zyre vendore.*

Sa më sipër duke ju referuar numrit total të të dënuarve me dënime alternative që mbikëqyren nga Shërbimi i Provës prej **2578** të dënuarish, numri mesatar i të dënuarve që mbikëqyren nga një punonjës në nivel vendi aktualisht është **86**. E shprehur kjo për çdo zyrë vendore është si më poshtë:

- Zyra Vendore Tiranë ka nën mbikëqyrje **107** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Durrës ka nën mbikëqyrje **80** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Fier ka nën mbikëqyrje **68** të dënuar për çdo punonjës.

- Zyra Vendore Shkodër ka nën mbikëqyrje **124** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Lezhë ka nën mbikëqyrje **50** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Elbasan ka nën mbikëqyrje **66** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Korçë ka nën mbikëqyrje **75** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Gjirokastrë ka nën mbikëqyrje **57** të dënuar për çdo punonjës.

**Duke ju referuar statistikave, gjatë periudhës 1 Janar - 28 Shkurt 2010 kanë përfunduar periudhën e mbikëqyrjes 76 të dënuar. Shtesa për periudhën 1 janar-28 shkurt 2011, prej 318 të dënuarish nën mbikëqyrje, rrit dhe ngarkesën e punës për specialistët.**

### **3. Numri i të dënuarve për secilin lloj dënimi alternativ.**

Statistikat për periudhën **01.06.2009 - 28.02.2011**, për secilin lloj dënimi alternativ, për të dënuarit e mbikëqyrrur nga Shërbimi i Provës, janë si më poshtë:

- **2257** persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 59 i KP "*pezullim i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë*", shifër kjo e barabartë me **78.64 %** të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- **59** persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 59/a i KP "*qëndrim në shtëpi*", shifër kjo e barabartë me **2.06 %** të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- **312** persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 64 i KP "*Lirim me kusht*", shifër kjo e barabartë me **10.87 %** të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- **242** persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 63 i KP "*Pezullim i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik*", shifër kjo e barabartë me **8.43 %** të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.

- asnjë person nuk është dënuar nga gjykata duke aplikuar nenin 58 të KP "gjysëmliria".

Këto të dhëna pasqyrohen më poshtë, në Tabelën 2.

**Tabela 2: Numri i të dënuarëve sipas llojeve të dënimeve alternative të dhëna nga Gjykata për periudhën 01.06.2009 – 28.02.2011.**

Nr	LLOJI I DËNIMEVE ALTERNATIVE	Nr. TOTAL	TOTALI në %
1	Pezullimi ... neni 59 i KP	2257	78.64%
2	Qëndrimi në shtëpi neni 59/a i KP	59	2.06%
3	Lirimi me kusht neni 64 i KP	312	10.87%
4	Punë në interes publik neni 63 i KP	242	8.43%
5	Gjysmëliria neni 58 i KP	0	0%
<b>TOTALI</b>		<b>2870</b>	<b>100%</b>

Për periudhën 01.06.2009 – 28.02.2011 numri i të dënuarëve me "punë në interes publik" është **242**, ndërsa pas përfundimit të këtij dënimi për 186 të dënuar, Shërbimi i Provës ka nën mbikëqyrje 56 të dënuar.

#### **4. Raportet e Vlerësimit me kërkesë të gjykatës dhe prokurorisë.**

Konkretisht për periudhën **1 janar-28 shkurt 2011**:

- ❖ Janë kërkuar nga gjykatat **92** raporte vlerësimi për persona të pandehur dhe të dënuar,
- ❖ Janë kërkuar nga prokuroritë **101** raporte vlerësimi për persona nën hetim dhe të pandehur,
- ❖ Kanë ardhur **318** urdhëra ekzekutimi nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, nga të cilët **52** urdhëra ekzekutimi janë për dënime alternative të dhëna për të mitur, për të cilët gjykata ka dhënë dënime alternative dhe kanë filluar procedurat ligjore të përcaktuara për procesin e mbikëqyrjes për ta.
- ❖ Ka përfunduar mbikëqyrja për **76** të dënuar me dënime alternative.

Ndërsa në total volumi i punës së Shërbimit të Provës për periudhën **01.06.2009 - 31.12.2010** jepet si më poshtë:

- ❖ janë kërkuar nga gjykata **1210** raporte vlerësimi për persona të pandehur dhe të dënuar,
- ❖ janë kërkuar nga prokuroritë **597** raporte vlerësimi për persona nën hetim dhe të pandehur,
- ❖ Kanë ardhur **2870** urdhëra ekzekutimi nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, nga të cilët **441** urdhëra ekzekutimi janë për dënime alternative të dhëna për të mitur, për të cilët gjykata ka dhënë dënime alternative dhe kanë filluar procedurat ligjore të përcaktuara për procesin e mbikëqyrjes për ta.
- ❖ Ka përfunduar procesi i mbikëqyrjes për **292** të dënuar.

## II. Bashkëpunimi me partnerët

- *me OSBE, OJF-të dhe partnerët.*

- Në datën 31 Janar 2011, nën mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, zhvilloi në qytetin e Korçës, një seminar trajnues me temë "Alternativat e dënimit me burgim dhe mundësitë e bashkëpunimit me pushtetin vendor." Ky seminar me pjesëmarrjen e punonjësve social të pushtetit vendor nga 26 njësi të qeverisjes vendore të Qarkut Korçë, (këshillit të qarkut, 2 bashkive, dhe 23 komunave të këtij qarku), me të cilët Shërbimi i Provës ka lidhur memorandume bashkëpunimi, u zhvillua në ambjentet e Hotel "Grand" në Korçë. Ky trajnim pati vlerë, lidhur me zbatimin në praktikë të marrëveshjeve të bashkëpunimit që kemi lidhur me këto njësi. Lektorët trajnues në këtë seminar ishin të gjithë punonjës nga Shërbimi i Provës. Në fund për pjesëmarrësit u shpërndanë certifikata.

Gjithashtu, në datat 17-18 shkurt 2011, Prezenca e OSBE-së, organizoi në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, në ambjentet e Hotel "Rogner", një trajnim për aftësitë menaxhuese për drejtorët dhe inspektorët e Shërbimit të Provës në Shqipëri. Në këtë trajnim ku morrën pjesë rreth 16 pjesëmarrës nga Zyrat Vendore dhe

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, referuan dy lektorë, ekspertët: Z. Ioan Durnescu, ekspert ndërkombëtar për Shërbimin e Provës, si dhe Z. Gazmend Haxhia, ekspert vendas në Menaxhim. Në fund të trajnimit u shpërndanë çertifikata për pjesëmarrësit nga përfaqësuesi i OSBE-së, Z. Matthias Zander, Këshilltar i Lartë Ligjor dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës.

- Për sa i përket bashkëpunimit me OJF-të, përveç Memorandumeve të Bashkëpunimit që kemi me 4 OJF, për të cilat ju kemi bërë me dije në raportet e mëparshme, në muajin Shkurt kemi nënshkruar edhe 2 memorandume me OJF-të si më poshtë:

Me Komunitetin Emanuel, i cili ofron shërbime mbështetjeje dhe këshillimi për të rinjtë me probleme narkotike, të alkooltoksikodipendencave dhe familjarëve të tyre, si dhe formim profesional dhe riintegrim në shoqëri, qendër krize dhe orientimi, terapi individuale dhe në grup, riaftësim dhe shoqërim psikopedagogjik etj, për të dënuarit e referuar nga Gjykatat dhe Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore.

Me Qendrën Sociale Murialdo, me qendër në Fier, e cila ka si objekt, të nxisë formimin profesional duke ofruar kurse të ndryshme profesionale si, për mekanik, hidraulik, marangoz, asistencë zyre etj, si dhe veprimtari me karakter edukativ, sportiv, kulturor dhe artistik, për të kontribuar në procesin e riintegrit të të dënuarve me dënime alternative.

- Në lidhje me mbarëvajtjen e punëve për projektin e binjakëzit me Shërbimin e Provës Britanik, (Albanian Twinning Project – Probation Service, AL 09 IB JH 01 “Support to the Establishment of the Probation Service and Alternative Measures to Detention”, janë bërë disa ndryshime në lidhje me personat përgjegjës të komponentëve, për palën përfituese, duke u nisur nga qëllimi, që secili prej komponentëve, të ketë një përgjegjës që është punonjës i Shërbimit të Provës. Në kuadër të përmbushjes së detyrimit nga ana jonë ju dërgua informacioni Z. Alan John MacDonald, këshilltar resident, në lidhje me personat përgjegjës për komponentët e projektit, si dhe vazhdon bashkëpunimi me përfaqësuesin

e këtij projekti, për çështjet që kanë të bëjnë me të. Gjatë muajit mars 2011 pritet të zhvillohet edhe ceremonia zyrtare e fillimit të këtij projekti.

**- me organet e pushtetit qendror dhe pushtetin vendor**

Në muajin Shkurt 2011, u nënshkrua Marrëveshja e Bashshkëpunimit me Policinë e Shtetit, Nr. 197 prot, datë 31.01.2011 dhe Nr. 301/3 prot, datë 08.02.2011, "Për sigurimin e bashkëpunimit midis dy institucioneve për përmbushjen e detyrave funksionale". Kjo marrëveshje është mjaft e rëndësishme në funksionimin e Shërbimit të Provës, për të bërë të mundur zbatimin e detyrimeve të vendosura nga gjykata, sipas parashikimeve ligjore, për të dënuarit me dënime alternative, ku një rol të rëndësishëm luan dhe Policia e Shtetit.

Përveç 66 memorandumeve të bashkëpunimit midis Shërbimit të Provës dhe organeve të qeverisjes vendore, për të cilat ju kemi bërë me dije në raportet tona të mëparëshme, për periudhën janar – shkurt 2011, kemi nënshkruar edhe 12 memorandume bashkëpunimi me njësitë e qeverisjes vendore të qarkut Gjirokastrë dhe konkretisht me:

1. Këshilli i Qarkut Gjirokastrë
2. Bashkia Tepelenë
3. Bashkia Përmet
4. Bashkia Libohovë
5. Bashkia Këlcyrë
6. Komuna Lunxheri/ Gjirokastrë
7. Komuna Fshat Memaliaj/ Tepelenë
8. Komuna Cepo/ Gjirokastrë
9. Komuna Antigone/ Gjirokastrë
10. Komuna Zagori/ Gjirokastrë
11. Komuna Dropull i Poshtëm/ Gjirokastrë



## 12. Komuna Odrie/ Gjirokastër.

Pra në total janë nënshkruar 78 memorandume bashkëpunimi me organet e qeverisjes vendore dhe konkretisht me 6 Këshilla Qarqesh, 27 Bashki (nga të cilat 5 Njësi Bashkiake) dhe 45 Komuna. Ndërkohë që vazhdon puna dhe korespondenca për nënshkrimin e memorandumeve të bashkëpunimit edhe me bashkitë dhe komunat e tjera.

### III.-Problematika e punës.

#### 1.- Zyrat e reja Vendore dhe ngarkesa.

Gjatë muajve Janar - Shkurt 2010 kemi vazhduar me intensitet menaxhimin e punëve për sistemimin në ambiente normale pune, të zyrave vendore të Shërbimit të Provës, si dhe të sigurimit të infrastrukturës për to, me qëllim mirëfunksionimin e aktivitetit të këtyre zyrave vendore.

Sikurse ju kemi bërë me dije dhe në kërkesë-propozimin tonë me nr. 88 Prot., datë 13.01.2011, për ndryshimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit të Provës, si dhe në Raportin Vjetor mbi aktivitetin e Shërbimit të Provës, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2010, dërguar me tonën nr. 378, datë 28.02.2011, problemi kryesor del hapja e zyrave të reja vendore me vendodhje në të gjitha rrethet gjyqësore ku nuk janë ngritur ende, si dhe ndryshimi i strukturës dhe shtimi i organikës së Shërbimit të Provës, me qëllim administrimin dhe ushtrimin e funksioneve në mënyrën e kërkuar nga ligji dhe arritjen e standardeve të parashikuara në Strategjinë Sektoriale të Drejtësisë dhe SKZHI-së, për Shërbimin e Provës, ku një nga indikatorët është dhe raporti i numrit të dënuarve që mbikëqyren mesatarisht për një specialist të Shërbimit të Provës, përkatësisht 35 të dënuar /specialist.

Mjafton të përmendim se deri tani janë në mbikëqyrje nga institucioni ynë 2578 të dënuar, ose mesatarisht **86 të dënuar për çdo specialist**, numër i cili vazhdon të rritet, dhe që është më i lartë se standartet e vendeve europiane, pa shtuar këtu faktin se punonjësit tanë deri më tani kanë hartuar mesatarisht edhe **60 raporte vlerësimi për specialist**, sipas kërkesave të gjykatave dhe prokurorive, gjë që e bën të papërbalueshme ngarkesën e punës.

Duke shpresuar se kemi dhënë një analizë që pasqyron me objektivitet punën e kryer, si dhe një paraqitje të problematikës themelore nga Shërbimi i Provës, Ju sigurojmë se zbatimi i të gjithë detyrave funksionale, rritja e nivelit dhe e profesionalizmit do të jenë prioritete të punës sonë edhe në të ardhmen.

Me respekt,

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**ARBEN SEFGJINI**

